



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 05.

Prizrenë, më 29.01.2015, në ora 10:00

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Milosavljević, Agim Ceku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Slavko Simić, Jasmina Živković, Čerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Mungon: Blerim Shala dhe Milka Vuletić.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësuesja nga OSBE-ja Ardiana Gashi dhe Senad..

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë-Natasa Prica-Tishma Zyrtare e lartë ligjore-Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Milosavljević, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Hartimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2015;**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Hartimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2015;

Kryesuesi - konstatoi se puntoria e punës mbahet me datën 28 dhe 29, në Prizren me qëllim që Komisioni të finalizoi Draft planin e punës. Puntoria zhvillohet në bashkëpunim me administratën dhe misionin e OSBE-së.

Duke pasur parash përfundimin e kryesisë, mbi bazën e programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2015, të hartohet plani i punës dhe programi i punës së komisionit për vitin 2015, deri më 2.02.2015.

Për arsye të respektimit të afateve kohore, dita e dytë e punës ka karakter të mbajtjes së mbledhjes të komisionit me këtë agjendë: Shqyrtimi i planit të punës për vitin 2015, shqyrtimi i agjendës legislative për vitin 2015, aktivitetet e mbështetura nga organizatat e tjera, Planifikimi i buxhetit dhe të ndryshme.

Pas shqyrtimit të Draft-Planit të Punës për vitin 2015, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të njejtart i miratoi si në vijim:

1. Detyrë kryesore e Komisionit është shqyrtimi i të gjitha Projektligjeve në procedurë, në aspektin e të drejtave, interesave të komunitetit dhe kthim me raportet e komisionit funksional;
2. Në bazë të programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2015, si komision Funksional shqyrton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
3. Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjeve nga ana e Komisionit është njëra nga kompetencat kryesore për vitin 2015. Komisioni, formon grupe punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve;
 - Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe,
 - Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit,
 - Ligji për ndryshim dhe plotësim të ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
 - Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (posaçërisht neni 11),
 - Ligji për Vetëqverisje locale dhe
 - Ligji për financat e Pushtetit Lokal (mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrja buxhetore).
4. Raportimi periodik i ministrit, në trajtimin e çështjeve të caktuara nga fushëveprimtaria e komisionit,
5. Procesi i mbikëqyrjes së buxhetit të resorit përkatës, në mbështetje të partneritetit të OSBE-së (organizimi i trajnimeve dhe aktivitetet rrjedhëse);
6. Vizita e Komisionit në teren lidhur me procesin e monitorimit të ligjeve dhe mbikëqyrjen buxhetore, në mbështetje financiare nga misioni i OSBE-së;
7. Vizitë pune e Komisionit në regjion;
8. Vizitë studimore e Komisionit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
9. Komisioni përcakton një përfaqësues të vet për pjesëmarrje në shënimin e “ditëve festive për komunitete” , në vende të ndryshme të Republikës së Kosovës
10. Plotësimi eventual i Planit të Punës

Në bazë të propozimeve të miratuar në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 ,7, 8, 9 dhe 10, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxorri këtë .

Përfundim

Komisioni miratoi Planin e Punës për vitin 2015, ne datën 29.01.2015,

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Saša Milosavljević